



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 04 .

Prishtinë, më 15.11.2017, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i Komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Sinik dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja Senad Karaahmetovic; përfaqësues nga EUSR/EU Blerta Bejtullahu; përfaqësues nga RTK-2; këshilltar i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafit mbështetës të Komisionit: koordinatorë e komisionit - Natasha Prica-Tishma, dhe Drita Çarkaxhiu - zyrtarë e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit, *Igor Simiq*.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i zëvendësministrit në lidhje me ndarjen buxhetore në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim si dhe Zyrës për Çështje të Komuniteteve pran Zyrës së Kryeministrit, sipas Projektligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.**

I ftuar: zëvendësministër i Ministrisë së Financave zot, Fatmir Gashi

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

- 2. Raportim i zëvendësministrit në lidhje me ndarjen buxhetore në Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim, si dhe Zyrës për Çështje të Komuniteteve pran Zyrës së Kryeministrit, sipas Projektligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.**

Kryetari, duhet theksuar se është i ftuar zëvendësministri i Ministrisë për Financa, z.Fatmir Gashi, që të raportojë lidhur me planifikimin buxhetor nga ana e ministrisë për Financa, të bazuar në Projektligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, vijë buxhetore për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim si dhe Zyrës për çështje të Komuniteteve pran zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Fatmir Gashi - zëvendësministër i MF-së, tha se me kënaqësi do të elaborojë çështjet që ndërlidhen me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018. Bazuar në Projektligjin për Buxhetin e këtij viti, shuma e të hyrave është ndarë në vlerë prej 1.829.000. €, për shpenzime kapitale në vlerë prej 2.882.000 €, pra shpenzimet janë rritur për 15%, investimet kapitale për 37% , që do të thotë se marrin pjesë në buxhetin e Republikës së Kosovës në vlerë prej 33%. Theksoi se formulari ose rregulli tatimor i përcaktuar nga MF duhet të ruhet, me një deficit prej 1.7% dhe bilanci vjetor për të ardhurat e përgjithshme prej 4.5%.

Linja buxhetore në Ministrinë për Komunitete, është ndarë në vlerë prej 796.000 € për paga dhe mëditje, 375.652 € për mallra dhe shërbime, 16.154 € për shërbimet publike dhe 300.000 € për subvencione dhe transferta. Për investime kapitale, Ministria ka ndarë shumën prej 6.900.000 €, shumë kjo e destinuar për tri projekte: për kthimin dhe riintegrimin në vlerë prej 1.000.000 €, për ndërtimin e shtëpive për banim 2.400.000 € dhe projekti për komunitete 3.500 .000 €.

Si pjesë e projektit të buxhetit për Zyrën për Komunitete pran Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, shpenzimet e llogaritura janë nadre në këtë kategori: për paga dhe mëditje arrijnë në vlerë prej 43.335 €, për mallra dhe shërbime 30.893 €, për shërbimet publike 1.700 € dhe për subvencione dhe transfere 1.200.000 €.

Me rishikimin e buxhetit në vitin 2017, ndryshimet janë bërë me një kod të veçantë ku 3.000.000 € janë transferuar në vijën tjetër dhe për këtë vit suficiti buxhetor është 4.361.000 €, Sa i përket ndarjes buxhetore për vitin 2018, është prarapar shuma në vlerë prej 8.387.806 €, që do të thotë se buxheti për këtë viti është dyfishuar.

Sasha Milosavleviq, parashtojë pyetje për zëvendësministrin, nuk e ka të kjar pse tërë kohën u diskutua për ndarjen e mjeteve buxhetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, kur dihet se përgjegjësia i takon edhe ministrive të linjave tjera, andaj mirë është që kjo praktikë të mos përsëritet në të ardhmen . Ai dha propozim konkret, që Qeveria gjatë planifikimit të mjeteve buxhetore të obligojë edhe ministrinë resore, me qëllim të zgjidhen çështjet të cilat janë me prioritet, ndër to janë arritja e promovimit të të drejtave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

Kijtim Shala, raportimi i zëvendësministrit ishte shumë i qartë. Kur bëhet fjalë për projektet kapitale, ai kërkoi të dijë se cilat janë raportet në mes MKK-së dhe digasterëve tjerë, kryesisht në fushën e kulturës, rinisë, sportit, kryesisht për temat të cilat ndërlidhen në interesë për komunitetet. Në bazë të informatave që murrëm, shihet se shuma buxhetore e MKK nuk është e madhe. Duhet theksuar se buxheti në vlerë prej 4,361,000 €, është funksional . Për arsyet tashmë të njohura buxheti i po këtij vit ka mbet i pa shfrytëzuar dhe i njejtë është transferuar në linjën tjetër.

Sa i përket projektit në vlerë prej 2.400.000 euro i cili parashihet për ndërtimin e 292 shtëpive për banim, është çështje e cila i takon MKK-së. Konsideron se mirë është që detyrimet të ndahen me ministrinë relevante, kushti i domosdoshëm për të krijuar kushte komuniteteve. Ai dha propozim konkret, me kërkesë që MKK të dërgojë pasqyrën financiare me emra, mbiemra dhe shifra, i cili raport do të ndihmon në pasqyrimin e qartë dhe transparencë të shpenzimeve . Pas vlerësimit të të njëjtës, do të kemi një konsensus në zgjidhjen adekuate të situatës në fjalë. Është e një rëndësie të veçantë, të ndërtohen pishinat, hallat sportive, në pjesën veriore të Mitrovicës.

Danush Ademi, Sipas raportit të zëvendësministrit, shuma e mjeteve buxhetore në vlerë prej 2.400.000 €, është projekt i cili parasheh ndërtimin e 292 shtëpive. Ai theksoi se Komuniteti ashkali jeton në varfëri të skajshme dhe ata nuk kanë as kulm mbi kokë. Edhe pse kjo çështje kërkon trajtim të veçantë, këto mjete a janë dedikuara për ndërtimin e shtëpive për komunitetin malazez, serb, maqedonas dhe për komunitetet të cilat kthehet nga vendet e treta evropiane. Kërkojë që kjo çështje të merret seriozisht dhe të gjendet zgjidhja me qëllim që të fillohet me ndërtimin e shtëpive për kategorin e komunitetit tim. Kur bëhet fjalë për projektin në vlerë prej 3.500.000 €, ishte i interesuar të dijë se nga ana e kujt janë shpenzuar këto mjete dhe si çështje e dytë, cilat janë arsyet e kthimit të shumës prej 3.000.000 €, në Qeveri.

Në vitin e kaluar, me rastin e rishikimit të buxhetit, GP 6+ ka dalë me propozim konkret, që të formohet kod i veçantë për shfrytëzimin e buxheti për kokë të banorit. Kjo kërkesë ka pas mirëkuptim dhe e njëjta është miratuar në Kuvend, mirëpo, deri sot, nuk është realizuar asnjë projekt.

Me rastin e hartimit të buxhetit për vitin 2018, shihet se ka pasur vullnet të mirë nga ana e Ministrisë së Punë dhe Mirëqenie Sociale, e cila ka marrë përgjegjësin rreth menaxhimit të mjeteve buxhetore, sidomos për investime kapitale në emër të komunitetit joshumicë.

Jasmina Zivković, Edhe përkundër faktit që kanë kaluar 17 viteve pas përfundimit të luftës, nuk është i kënaqur komuniteti serb lidhur me zhvillimin e procesit të kthyerve. Problemi qëndron në Ministrinë e Financave, e cila ka për detyrë të ndaj mjeteve buxhetore, me qëllim të realizimit të projektit e të kthyerëve për komunitetin tonë, pasi edhe atyre ju takon të jetojë njëjtë, si çdo qytetar i Kosovës.

Ajo parashtroi dy pyetje, nën një, sa respektohen procedurat nga ana e MF-ve, për iniciimin e kërkesa e të interesuarëve që dëshirojnë të kthehen. Dhe, nën dy, sa mjete buxhetore i ka ndarë kjo ministri për punësimin e komuniteteve, si në nivelin qendror, ashtu dhe atë lokal.

Fatmir Gashi, së pari u përgjigj në pyetje e z. Shala, duke thënë se ministria e financave në vazhdimësi i shqyrton kërkesat buxhetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit. Sa i përket shfrytëzimit buxhetor, të gjitha ministrinë kanë impakt në Komunë, komunat kanë buxhet të veçantë, pra ndarja bëhet njëjtë për kokë të banorit.

I njoftoi anëtarët e komisionit, se buxheti i konsoliduar në vlerë prej 3.500.000 €, është i destinuar vetëm për projektin e Komuniteteve, dhe jo për projektin e Kthimit dhe Riintegritimit. MKK-ja gjatë vitit 2017, ka shfrytëzuar vetëm 1.500.000 €, ndërsa të pashfrytëzuar kanë mbetur 3.000.000 €. Me rastin e rishikimit buxhetor të vitit 2017, me kod të veçantë janë bartë mjetet e pashfrytëzuara në linjë tjetër. Për problematikat e lartcekura, si ministri, kemi kërkuar nga MKK-ja që të hartojë një raport për procedurat e kthimit; sa është numri i të interesuarve për kthim, në cilat rajone do të vendoset kjo kategori e qytetarëve, cili është projekti final për ndërtimin e shtëpive, mirëpo, deri më sot nuk kemi marr asnjë informat nga ministria e linjës.

Kur bëhet fjalë për çështjen e punësimit, mundësinë më të favorshme e kanë qytetarët e komunitetit serb, i cili jeton në pjesën veriore të Mitrovicës, të cilët gëzojnë fondin për zhvillim, fond ky i cili është arritur me marrëveshjen e Brukselit. Ndërsa, gjendja e komuniteteve tjera joshumicë, është shumë e pavolitshme sepse është shumë i madh numri i të papunëve të kësaj kategorie.

Gashi, theksoi se ka marr pjesë në takimin i cili është mbajtur në ditën e djeshme, ku është diskutuar lidhur me projektin e ndërtimit të pishinës në pjesën veriore të Mitrovicës. Unë isha kundër këtij propozimi nga se ky fond mund të shfrytëzohet për çështje parësore, siç janë, ngritja e infrastrukturës, punësimi, dhënia e granteve, pra të mos shfrytëzohet për çështje sekondare, siç është ndërtimi i pishinave, dhe kjo është arsye e vetme që nuk e kam votuar këtë propozim.

Xhelal Sveçla, tha se kishte përgatitur disa pyetje , por përgjigjet, paraprakisht u morrën gjatë diskutimit të zëvendësministrit. Kryesisht, është i interesaur të di se nga ana e kujt është dhënë propozimi për ndërtimin e 292 shtëpive për banim, në cilat qytete do të ndërtohen shtëpitë, për cilën kategori të komuniteteve. Mes tjerash, cilat mekanizma e kushtëzojnë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, të dërgojë programin e shpenzimeve të mjeteve buxhetore, apo do të vazhdohen praktikat e mëhershme dhe ndarja e buxhetit të bëhet në formë paushalle.

Ai propozoi që raporti i MKK-së, të përmbajë specifikat e vijës buxhetore, në veçanti në fushën e infrastrukturës, arsimit, kulturës, shëndetësi. Gjithashtu, të inicohet procedura për projektin e kthimit dhe riintegrit. Roli kryesor i yni është që të monitorojmë punë e institucioneve me qëllim që në të ardhmen të mos përsëritet e njëjta që të ketë prioritet një komunitet e tjetri të jetë i diskriminuar.

Albert Kinolli, për hir të korrektësisë, zëvendësministri është obliguar të raportojë vetëm për mjetet buxhetore në bazë të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018, ndërsa për linjën buxhetore do të raportojë ministri përkatës .

Në Kosovë, 30% e komunitetit joshumicë jeton në kufirin e varfërisë, sidomos komuniteti romë i cili jeton me social prej 75 €, ndërsa ata janë taksapagues të rregullt.

Ne, sot u informuam se me kod të veçantë janë kthyer në Qeveri 3.000.000 €, fakt ky i cili është i paarsyeshëm pasi këto mjete kan qen të dedikuara të shfrytëzohen për kërkesat e shumta të komuniteteve.

Sa i përket çështjes së ndërtimit të 292 shtëpive në vlerë prej 2.400.000 euro, kërkoi të informohet se për cilën kategori të komuniteteve do të ndërtohen këto shtëpi. Mund të them, se pas luftës, janë kthyer 870 banorë të komunitetit romë, dhe ata ende nuk kanë kulm mbi kokë. Ishe i mendimit se, duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me MKK-në, sidomos kur bëhet fjalë për projektin e kthimit dhe riintegrit si dhe avancimi i tyre në shoqërinë kosovare . Në suaza të asaj që u diskutua, propozoi që në një të ardhme të afërt të ftohet në komision ministri për MKK-në, me qëllim që të ndëgjojmë për menaxhimin e mjeteve buxhetore në vlerë prej 3.000.000 €, dhe arsyeja e kthimit të këtyre mjeteve në Qeveri.

Kryetari, në bazë të raportimit të zëvendësministrit, kuptuam se buxheti i konsoliduar të vitit 2018 është dyfishuar, për të cilin fakt nuk pajtohet , ngase buxheti i MKK-së për vitin 2017 ka qenë 7.700.000 E, ndërsa në vitin 2018 është caktuar në vlerë prej 8.387.806 €, kështu që nuk e sheh të arsyeshme se buxheti është dyfishuar.

Sipas mendimit të tij nuk mund të ndahet mjetet buxhetore të MKK-së, veqmas për secilin komunitet por përgjegjëia bie edhe në ministrinë rerore.

Në kontakt me ministrin z. Dalibor Jevtiq, jamë informuar se kjo ministri në kontinuitet i shqyrton kërkesat e parashtruara nga komunitet dhe se menaxhimi i mjeteve buxhetore të kësaj ministrie mvaren nga agjenda e takimeve Parlamentare. Situata ka qen e tillë se këtë vit takimet kanë qenë të pakta dhe zgjedhjet qendrore kanë zgjatur tre muaj. Këto janë arsyet për të cilat nuk është arritur në plotni të menaxhohet buxheti për vitin 2017.

Kur bëhet fjalë për punësimin e të rinjve, është çështje me të cilën duhen të merren të gjithë institucionet, e jo vetëm Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Nuk është i mendimit të njejt me zëvendësministrin, se ndërtimi i pishinës është i panevojshëm. Diskutoi se 25 mijë banorë jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës, dhe një numër i madh i nxënësve studiojnë në fakultetin e edukatës fizike. Ndërtimi i bazenit do të ishte në lavërdi të qytetarëve të këtij rajoni, me ç'rast do t'ju mundësohet hapja e 30 apo 50 vendeve të punës.

Zoran Mojsilović, nuk përkrahë qëndrimin e zëvendësministrit lidhur me mospërkrahjen e projektit për ndërtimin e pishinës, Në pjesën veriore të Mitrovicës, që nga viti 2013 nuk ka pasur investime kapitale. Ai theksoi se nuk është hera e parë që qëndrimet e tilla ndikojnë negativisht në mos miratimin e këtij buxheti i cili do të dëmtojë bizneset dhe investimet tjera. Duhet theksuar se më se e nevojshme është ndërtimi i pishinave, sallat sportive edhe në komunat e banuara me qytetarë të komunitetit serbë.

Fatmir Gashi, dha shpjegime shtesë se me rastin e miratimit të buxhetit për vitin 2017, në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim janë ndarë gjithsejtë 7.700.000 €, ndërsa në vitin 2018, buxheti është ndarë në vlerë prej 8.387.807 €, që i bie se ndryshimi është 600-700 mijë euro, dhe kur bëhen kalkulimet e përgjithëshme, del se buxheti për vitin 2018, është i dyfishuar. Mirëpo, kur merret për bazë rishqyrtimi i buxhetit për vitin 2017, është vendosur që me kod të veçantë të kthehen 3000.000 € në linjë tjetër, dhe buxheti i kësaj ministrie është 4,361,000 €, Në kuadër të projektit për ndërtimin e 292 shtëpive për qytetarët të cilët dëshirojnë të kthehen, ka mungesë të informatave për numrin e të kthyerve, në cilat komuna do të ndërtohen shtëpitë.

Sidoqoftë, si ministri, përsëri do të kërkojmë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, të hartojë një program të detajuar në lidhje me destinimin e mjeteve buxhetore, më pas, i njëjti do ta shqyrtohet nga ana jonë, dhe në bazë të vlerësimeve do të selektohen vijat buxhetore për projektin e kthimit dhe riintegritit dhe linjat tjera.

Mënyra se si menaxhohet buxheti i MKK-së, është problemi i brendshëm i ministrisë, e cila obligohet t'ju informojë për çdo shpenzim buxhetor dhe për investimet kapitale. Pra duhet ndryshuar qasja politike, ku me grande do të promovohet rritja ekonomike dhe mundësia t'ju ndihmohet komuniteteve në zbutjen e varfërisë.

Rasim Selமானaj, theksoi se gjatë këtij takimi u hapën shumë tema dhe përgjigjet ishin shumë korrekte nga ana e zëvendësministrit. Për çështjet e ngritura nuk është në kompetencë të Ministrisë së Financave të bëjë zgjidhje për të gjitha kategoritë. Mendon, se është mirë që në takimin e radhës të ftohet ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, me qëllim të raportojë lidhur me prioritet e linjës buxhetore të kësaj ministrie.

Kryesuesi, pajtohet me propozimin e anëtarëve të Komisionit që të ftohet ministri i MKK Dalibor Jevtiq, të raportojë lidhur me menaxhimin e mjeteve buxhetor të resorit që ai udhëheq dhe çështjet tjera që u ngritën nga anëtarët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit,

Igor Simiq